Kronikë

Tiranë/ Miku i Ervis Martinajt kapet me armë në makinë te 'Komuna e Parisit'! Valentino Kaçorri i dënuar për vrasje e trafik armësh e subjekt i OFL-së

Valentin Kaçorri, miku i Ervis Martinajt është arrestuar nga policia e Tiranës pasi është kapur duke qarkulluar me armë zjarri në makinën në zonën e Komunës së Parisit

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Redaksia
17 Dhjetor, 10:50 | **Përditesimi: 17 Dhjetor, 14:32**

TIRANË- I dënuar në Itali për vrasje e trafik armësh, dhe i vënë në 2020-ën në ***shënjestrën e OFL-së***, Valentino Kaçorri u arrestua nga Policia e Tiranës pasi u kap nga forcat "Shqiponja" me armë zjarri në makinë teksa lëvizte në zonën e Komunës së Parisit në Tiranë.

44-vjeçari është një emër i njohur për policinë, pasi ka qenë anëtar i Këshillit të Mbikëqyrjes në King Casino, në pronësi të Ervis Martinaj, por e mbyllur prej vitesh.

LEXO EDHE:
Rama falenderon mjekët dhe infermierët: Deri në përfundim të këtij mandati, pagat tuaja do rriten deri në 100%! Do nisë shtrirja në terren e autonomisë spitalore

Në shkurt të 2020-ës Operacioni Forca e Ligjit i kërkoi të vetëdeklarojë pasurinë, në të njëjtën kohë që formularin ia dërgoi edhe Ervis Martinajt, sot i zhdukur prej muajit gusht, dhe që ende policia nuk e ka një përgjigjje nëse është gjallë apo e kanë vrarë.

Ervis Martinaj, është në kërkim pas dëshmisë së Nuredin Dumanit që ka deklaruar se Martinaj i kishte ofruar 500 mijë euro për të vrarë Indrit Doklen.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: armëmbajtje pa leje | ofl | Tirane | valentino kacorri | Ervis Martinaj

Komento

Komente

Kuksi: 17/12/2022 14:28
Ky eshte djale i familjes se mire e te respektuar ne Mirdite. Ska qene i perzier kurre me asgje, mos rrini tu perzi lidhjet familjare jo kunati jo ky jo ai...
Përgjigju

Emi: 17/12/2022 15:36
Sa bukur kur komentohesh anonim nga njerez pa ..... qe te njohin,tipar i maskarenjve si puna jote. Per Anin

Lirimi: 17/12/2022 12:45
Si eshte e mundur qe gjithe klani i ervis martinajt ose po i kapin ose po i vrasin, a ka gisht shteti ketu? Po ofl pse nuk vepron po ka nje vit qe nuk degjohet me...
Përgjigju

nikla: 17/12/2022 11:19
ky o kunati i vis martinit
Përgjigju

Mirdita: 17/12/2022 15:19
E clidhje ka kunati kujt asht ky ? Ky para se mu ba dhanderr ke martint ka pas reputacionin e vet si djal e si familje ky me vllezen sot e 30vjet ste bje ne qaf e te vllajn edhe se nuk e kam njoft kurr e pak veta e kan munsin me njoft si ke djem ma te mir ne shqipni te beses burrnis e bujaris, kta veq miqsia i lidh me visin se te tjetrat kta jan djem nisha

gent: 17/12/2022 14:52
vellai i ben kacorrit! vellai keti bleu grandin ne sarande prone e vallit te ben malajt! ne 2013 rama shkoi per dreke dhe sdonte te pagunte leket. beni i tha do i paguash koker me koker se ste kam as hak ad bonxh dhe nuk me rruhet kush je! shkoj koco kokdhima e qetsoi dhe pagoj ai nga leket e veta. drka e rilindjes ka kushtu 1.2 mil te vjetra!

per Altinin: 17/12/2022 14:22
Burr i mer asht ai qe rrin ne punet e veta. Si ky si Beni nuk kane lane gja pa ba ne Itali e Shqipni. Kena Visin dhanderr thoshin

Ani: 17/12/2022 12:38
Fiks burri rones , punojn fort ne spanje jan grup i forte atje shum

Altini: 17/12/2022 12:36
Ky eshte mirditor djali me i mire qe ka nxjerr mirdita. Kush e njeh e di mire dhe e njohin. Ata qe e njohin e dine qe kurre ska qene perzi ne pune te martinajve

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Argjentina apo Franca, kush e fiton Botërorin e Katarit?
Argjentina | Franca | Nuk e di

Lajme të tjera

AMBULANCE
EMERGENCY
EMERGENCY
EMERGENCY